



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3386/ 5 prot.

Datë 12.12.2025

V E N D I M
Nr. 1849 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.12.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Edico Group” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-66983-10-28-2025, me objekt “Blerje Motorgjenerator”, me fond limit 4,060,315.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Edico Group” shpk, me Nipt, L82118039C, dhe adresë: Pallati 7 katësh kati 1 Mëzez , Rruga: “Kastriotet”
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, me adresë: Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën përmes shërbimit postar, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4 Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

1.5 Ankesa nuk ka respektuar afatet ligjore të ankesës.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29-10-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-66983-10-28-2025, me objekt “Blerje Motorgjenerator”, me fond limit 4,060,315.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 10.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 19.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Edico group” SHPK	3,763,845	lekë	skualifikuar
- “Eurocol Service ” SHPK	3,990,000	lekë	kualifikuar
- “Fred A ” SHPK	3,516,000	lekë	skualifikuar
- “PC store ” SHPK	3,045,236,25	lekë	skualifikuar
- “Solar Electric ” SHPK	3,365,000	lekë	kualifikuar
- “Vassa a ” SHPK	3,204,750	lekë	skualifikuar
- “Xheri’s Company ” SHPK	3,765,400	lekë	skualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “Edico group” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 2.3.3 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar . Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.” Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik është vetëm një përkthim në gjuhën shqipe i dokumentit origjinal në gjuhën angleze, në formë fotokopie, pa u njësuar me origjinalin. Kjo është në kundërshtim me nenin 129 “Vërtetimi i njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin” të Ligjit nr. 110/2018, datë 27.11.2018 “Për noterinë”, ku përcaktohet se: “Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin, si dhe të pasqyrojë çdo shënim, korrigjim, shtesë, fshirje ose shenjë tjetër të veçantë në dokument.” Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës është përcaktuar qartë se: “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.” Dhe gjuha e kërkuara në DST është gjuha Shqipe. Në këto rrethana, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi nuk është dorëzuar në formën e kërkuar (origjinale ose kopje e noterizuar), dhe për rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë për vlerësim të mëtejshëm nga KVO → Nuk plotëson pikën 2.3.2 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të motorgjeneratorit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DSTsë..” Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e

Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik është vetëm një përkthim në gjuhën shqipe i dokumentit origjinal në gjuhën angleze, në formë fotokopie, pa u njësuar me origjinalin. Kjo është në kundërshtim me nenin 129 “Vërtetimi i njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin” të Ligjit nr. 110/2018, datë 27.11.2018 “Për noterinë”, ku përcaktohet se: “Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin, si dhe të pasqyrojë çdo shënim, korrigjim, shtesë, fshirje ose shenjë tjetër të veçantë në dokument.” Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës është përcaktuar qartë se: “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.” Dhe gjuha e kërkuara në DST është gjuha Shqipe. Në këto rrethana, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi nuk është dorëzuar në formën e kërkuar (origjinale ose kopje e noterizuar), dhe për rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë për vlerësim të mëtejshëm nga KVO → Nuk plotëson pikën 2.3.7 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër shërbimin e transportit, montimin, vënien në punë, si dhe testimin e pajisjes objekt prokurimi pranë ambjenteve të Autoriteteve Kontraktore përfituese brenda afatit të parashikuar”. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik konfirmon se transporti do kryhet nga vetë O.E , por nuk përmend në asnjë pjesë se merr përsipër montimin, vënien në punë, si dhe testimin e pajisjes objekt prokurimi. Nisur nga kjo vërtetohet se deklarata paraqitur nga O.E nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në këtë kriter.

II.5. Në datën 25.11.2025, operatori ekonomik “Edico group” SHPK, ka paraqitur ankesë përmes shërbimit postar në Komisionin e Prokurimit Publik, me numër 13386 prot., ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga procedura e prokurimit objekt - ankimi.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.3386/1 prot., datë 26.11.2025, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 3514/6 prot., datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3386/2 prot., datë 11.12.2025, me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës...”, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, nga ku rezulton, që autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën e tij duke argumentuar: “[...] Ndodhur në kushtet ku ankesa e oe ankimues aktualisht buk rezulton e paraqitur në sistemin e ankesave elketronike KSHA Gjykon se kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Edico group” SHPK .

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Edico group” SHPK, me nr. 3886 prot., datë 25.11.2025, të paraqitur përmes shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në datën 10.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 19.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.4. Në datën 25.11.2025, operatori ekonomik “Edico group” SHPK, ka paraqitur ankesë përmes shërbimit postar në Komisionin e Prokurimit Publik me numër 3386 prot., ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, nga procedura e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.5. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.3386/1 prot., datë 26.11.2025, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

III.1.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 3514/6 prot., datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3386/2 prot., datë 11.12.2025, me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës...”, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues,

nga ku rezulton, që autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën e tij duke argumentuar:
“[...]

Ndodhur në kushtet ku ankesa e oe ankimues aktualisht buk rezulton e paraqitur në sistemin e ankesave elektronike KSHA Gjykon se kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Edico group” SHPK.

III.1.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III.1.8. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën me nr. 3386 prot., datë 25.11.2025 përmes shërbimit postar, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.9. Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës”, pika 1 paragrafi i parë të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”*

III.1.10. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.*

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se bazuar në ndryshimet e ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, të cilat gjejnë rregullim në ligjin nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 ‘Për prokurimin publik’” miratuar më datë 08.02.2024, botuar në fletoren zyrtare me nr. 40, me datë publikimi në fletoren zyrtare 03.04.2024, dhe hyrë në fuqi më datë 20.03.2024, çdo ankesë e operatorëve ekonomikë që mban datë të urdhërit të prokurimit pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore (datë 20.03.2024), duhet dërguar njëkohësisht në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Në rastin konkret, referuar verifikimeve në sistemin e ankesave elektronike, si dhe materialeve në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues me nr. 11658 prot., datë 21.06.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dhe në autoritet kontraktor përmes shërbimit postar, në kundërshtim me parashikimet e nenit 111 paragrafi i parë i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar dhe verifikimeve në sistemin e ankesave elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik më datë 25.11.2025 përmes shërbimit postar, ndërkohë që bazuar në ndryshimet ligjore (hyrë në fuqi më datë 20.03.2024), bazuar në datën e urdhrin të prokurimit të procedurës (23.05.2024), ankesa me nr. 1658 prot., datë 21.06.2024, nga operatori ekonomik “*Edico Group*” SHPK, duhej dërguar njëkohësisht në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik vetëm përmes Sistemit të Ankesave Elektronike. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik përmes shërbimit postar më datë 25.11.2025, konsiderohet e paraqitur në kundërshtim me parashikimet e nenit 111 pika 1 paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke mos respektuar kështu rrugën për paraqitjen e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, jo vetëm brenda afatit të parashikuar në ligj, por edhe duke ezauruar rrugën e duhur ligjore për paraqitjen e ankesës.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën me nr. 3386 prot., datë 25.11.2025, të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në KPP dhe autoritet kontraktor përmes shërbimit postar, ky i fundit nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e rrugës ligjore, për paraqitjen e ankesës sipas parashikimeve të nenit 111, pika 1, paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve të ankimit dhe i rrugës për paraqitjen e ankesës pas ndryshimeve ligjore është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa më sipër, ankesa me nr.3386 prot., datë 25.11.2025, e operatorit ekonomik “Edico Group”, SHPK e paraqitur përmes shërbimit postar, nuk pranohet.

III.1.13 Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues për ankesën e mësipërme nuk ka përdorur formularin përkatës të ankesës, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III. 1.14 Nga verifikimi i dokumentacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor rezulton se me shkrësën me nr. 3514/6 prot., datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3386/2 prot., datë 11.12.2025, me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës...” rezulton se autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues nëpërmjet postës elektronike për plotësimin e kushteve formale sipas parashikimeve ligjore konkretisht **neni 111 të LPP-së.**

III.1.15. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

Per sa me lart, duke qene se nuk mund te identifikohet objekti i ankesës apo pretendimet e ankimuesit, pasi nuk eshte paraqitur formulari i ankeses, bazuar ne nenin 94/5 te VKM-se 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar ku parashikohet se: "Ankesa duhet te korigjohet dhe paraqitet ne autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi. Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur", Personi i caktuar

per shqyrtimin e ankeses vendosi perfundimin e shqyrtimit te ankeses duke e vlerësuar si e paparaqitur. [...]”.

III.1.16. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës i ankesës. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës **me** nr. 3514/6 prot., datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3386/2 prot., datë 11.12.2025, me lëndë “*Mbi shqyrtimin e ankesës...*” rezulton se autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues nëpërmjet postës elektronike për plotësimin e kushteve formale sipas parashikimeve ligjore konkretisht **neni 111 të LPP-së**, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes sistemit elektronik të ankesave i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret paraqitjen e formularit të ankesës sipas formularit përkatës.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elementet e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (me datë 02 dhjetor 2025) operatorin ekonomik ankimues përmes komunikimit zyrtar elektronik, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, formularit të ankesës sipas formularit përkatës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është formulari standard i ankesës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

III.1. 17 Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

II.2. Në datën 10.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.18. Në datën 19.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Edico group” SHPK	3,763,845	lekë	skualifikuar
- “Eurocol Service ” SHPK	3,990,000	lekë	kualifikuar
- “Fred A ” SHPK	3,516,000	lekë	skualifikuar
- “PC store ” SHPK	3,045,236,25	lekë	skualifikuar
- “Solar Electric ” SHPK	3,365,000	lekë	kualifikuar
- “Vassa a ” SHPK	3,204,750	lekë	skualifikuar
- “Xheri’s Company ” SHPK	3,765,400	lekë	skualifikuar

III.1.19. Operatori ekonomik “Edico group” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 2.3.3 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar . Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.” Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik është vetëm një përkthim në gjuhën shqipe i dokumentit origjinal në gjuhën angleze, në formë fotokopie, pa u njësuar me origjinalin. Kjo është në kundërshtim me nenin 129 “Vërtetimi i njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin” të Ligjit nr. 110/2018, datë 27.11.2018 “Për noterinë”, ku përcaktohet se: “Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin, si dhe të pasqyrojë çdo shënim, korrigjim, shtesë, fshirje ose shenjë tjetër të veçantë në dokument.” Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës është përcaktuar qartë se: “Të gjitha

dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.” Dhe gjuha e kërkuara në DST është gjuha Shqipe. Në këto rrethana, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi nuk është dorëzuar në formën e kërkuar (origjinale ose kopje e noterizuar), dhe për rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë për vlerësim të mëtejshëm nga KVO → Nuk plotëson pikën 2.3.2 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të motorgjeneratorit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DSTsë..” Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik është vetëm një përkthim në gjuhën shqipe i dokumentit origjinal në gjuhën angleze, në formë fotokopie, pa u njësuar me origjinalin. Kjo është në kundërshtim me nenin 129 “Vërtetimi i njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin” të Ligjit nr. 110/2018, datë 27.11.2018 “Për noterinë”, ku përcaktohet se: “Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin, si dhe të pasqyrojë çdo shënim, korrigjim, shtesë, fshirje ose shenjë tjetër të veçantë në dokument.” Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës është përcaktuar qartë se: “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.” Dhe gjuha e kërkuara në DST është gjuha Shqipe. Në këto rrethana, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi nuk është dorëzuar në formën e kërkuar (origjinale ose kopje e noterizuar), dhe për rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë për vlerësim të mëtejshëm nga KVO → Nuk plotëson pikën 2.3.7 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër shërbimin e transportit, montimin, vënien në punë, si dhe testimin e pajisjes objekt prokurimi pranë ambjenteve të Autoriteteve Kontraktore përfituese brenda afatit të parashikuar”. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), KVO ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik konfirmon se transporti do kryhet nga vetë O.E , por nuk përmend në asnjë pjesë se merr përsipër montimin, vënien në punë, si dhe testimin e pajisjes objekt prokurimi. Nisur nga kjo vërtetohet se deklarata paraqitur nga O.E nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në këtë kriter.

III.1. 20 Në datën 25.11.2025, operatori ekonomik “Edico group” SHPK, ka paraqitur ankesë përmes shërbimit postar në Komisionin e Prokurimit Publik, me numër 13386 prot., ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga procedura e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.21. Neni 111, pika 1, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: “1. “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”

III.1.22. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”

III.1.23. Në nenin 97, pikat 2, “Afatet për paraqitjen e ankesave” të VKM-se nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”

III.1.24. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Edico Group” SHPK, ka paraqitur në datën 25.11.2025, nëpërmjet Shërbimit Postar, ankesën me numër ankimi A/2025/6127, datë 25.11.2025 dhe me numër protokoli nr. 3386/2025, datë 25.11.2025, autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërkohë nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor në këtë datë, pra 25.11.2025, nuk është publikuar as njoftim - fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën

kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datën 25.11.2025, (data që operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën), nuk ishte publikuar as njoftim fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis nga data e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, më datë 25.11.2025, afati i paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nuk kishte filluar ende, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, apo njoftimi i anulimit të procedurës, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit. Për sa më sipër, ankesa e depozituar, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 25.11.2025, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

III.1.25. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Edico Group” shpk, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Edico Group” shpk, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. me nr. REF-66983-10-28-2025, me objekt “Blerje Motorgjenerator”, me fond limit 4,060,315.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Edico Group” shpk.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

